

Kryepiskopi Joan hirotonis një hierodhjakon të ri



Fortlumtura e Tij, Kryepiskopi Joan, sot, më 21 qershor 2026 në të Dielën III të Mattheut drejtoi Liturgjinë Hyjnore dhe dorëzoi të riun Kristi Baka në Anagnost dhe Hierodhjakon Nifoni në Katedralen “Ngjallja e Krishtit” në Tiranë. Në Liturgjinë Hyjnore së bashku me Kryepiskopin meshuan edhe Mitropoliti i Gjirokastrës, Hirësi Nathanaeli; Episkopi i Amantias, Hirësi Ignati si edhe klerikë nga Kryepiskopata dhe Mitropoli të tjera. Besimtarë të shumtë pjesëmarrës në Liturgji Hyjnore iu përgjigjën njëzëri thirrjes: I DENJE të Kryepiskopit Joan.

Në fjalën e tij Kryepiskopi Joan e nxiti hierodhjakonin t’i shërbejë Zotit me të gjithë fuqinë, me të gjithë mendjen dhe me të gjithë shpirtin e tij. Nëse do të veprojmë kështu, Zoti do të na shpërblejë duke dërguar hirin e Shpirtit të Shenjtë dhe duke na mbrojtur nga çdo e keqe. Gjithashtu, Kryebariu ynë Joan ju kërkoi të gjithëve të luten për dhjakonin e ri, se Kisha ka nevojë për lutjet e besimtarëve. Të gjithë klerikët kanë nevojë për lutjet e besimtarëve, sepse lutja e fuqishme ndaj Zotit asnjëherë nuk kthehet duarbosh. Perëndia do ta dëgjojë lutjen tonë, nëse ne e bëjmë me zemër dhe me shpirt.

Hierodhjakon Nifoni ka studiuar Bachelor në Theologji Sociale dhe Shkenca

Religjoze në Departamentin e Theologjisë dhe Kulturës të Kolegjit Universitar “Logos” dhe po përfundon Masterin Profesional në Theologji Sociale dhe Praktike. Gjithashtu ai ka studiuar për Ekonomi dhe Muzikë Bizantine. I denjë në shërbim të Kishës dhe njerëzve!

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)